

Vendim nr. 56 datë 09.11.2023

(V-56/23)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahim, Marjana Semini, anëtarë, me sekretare Belma Lleshi, në datën 09.11.2023 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 4 (S) 2023 të Regjistrimit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: **SAJMIR BRAHIMI**, përfaqësuar nga avokati Saimir Vishaj, me prokurë.

SUBJEKT I INTERESUAR:

PROKURORIA E PËRGJITHSHME, përfaqësuar nga prokurori Arqilea Koça, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 20-2017-10/7, datë 10.01.2017 të Gjykatës së Apelit Gjyrokastër; nr. 00-2022-1809 (349), datë 21.12.2022 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 31, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27, 50, pika 4, 51/a, pika 1, shkronja “b”, 71, 71/a dhe 71/b të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Holta Zaçaj, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkuarit, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, parashtrimet me shkrim të subjektit të interesuar, Prokurorisë së Përgjithshme, i cili ka kërkuar pranimin pjesërisht të kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Sarandë, mbi bazën e kallëzimit penal të paraqitur nga shtetasi F.B., ka regjistruar procedimin penal nr. 346 të vitit 2014, në ngarkim të shtetasve Sajmir Brahimi dhe Q.B., për kryerjen e veprave penale “Vjedhja me armë” dhe “Plagosja e lehtë me dashje”, të kryera në bashkëpunim, të parashikuara respektivisht nga nenet 140 e 25 dhe 89 e 25 të Kodit Penal (KP).

2. Me vendimet nr. 23-2014-2158, datë 10.12.2014 (për kërkuesin Sajmir Brahimi) dhe nr. 23-2014-2157, datë 10.12.2014 (për të dyshuarin Q.B.) Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë ka caktuar ndaj tyre masën e sigurimit “Arresti në burg”, të parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale (KPP) dhe me vendimet nr. 2248 dhe nr. 2249, datë 18.12.2014, të po asaj gjykate, është vendosur deklarimi i ikjes së këtyre personave nën hetim.

3. Në vijim, gjatë gjykimit të çështjes penale ndaj këtyre dy shtetasve, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë ka deklaruar mungesën dhe vijimin e gjykimit në prani të mbrojtësit të zgjedhur nga familjarët e tyre, avokati Gj.I.

4. Në përfundim të gjykimit, me vendimin nr. 23-2016-229 (34), datë 29.01.2016, ajo gjykatë ka vendosur të deklarojë kërkuesin Sajmir Brahimi fajtor për kryerjen e veprës penale “Vjedhja me armë”, të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 140 e 25 të KP-së dhe dënimin e tij me 14 vjet burgim, si dhe për kryerjen e veprës penale “Plagosja e lehtë me dashje” të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 89 e 25 të KP-së dhe dënimin e tij me 1 vit burgim. Në aplikim të nenit 55 të KP-së, gjykata e ka dënuar kërkuesin me 14 vjet burgim. Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim për të pandehurit avokati Gj.I.

5. Në procesin gjyqësor në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë të pandehurit kanë qenë në mungesë dhe janë përfaqësuar nga avokatët Gj.I. dhe S.V., të caktuar nga familjarët e tyre me prokurën e posaçme të datës 23.05.2016. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Apelit Gjirokastrë, me vendimin nr. 20-2017-10/07, datë 10.01.2017, ka vendosur të ndryshojë vendimin nr.23-2016-229(34), datë 29.01.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, duke e deklaruar kërkuesin fajtor për kryerjen e veprës penale “Vjedhja me dhunë”, të kryer në bashkëpunim, në bazë të nenit 139 e 25 të KP-së, dhe dënimin e tij me 12 vjet burgim. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs edhe kërkuesi Sajmir Brahimi, i përfaqësuar nga avokati S.V.

6. Me shkresën nr. 00500/17 prot., datë 23.11.2022, Gjykata e Lartë ka njoftuar avokatin S.V., si përfaqësues i kërkuesit Sajmir Brahimi, për zhvillimin e seancës gjyqësore në datën 09.12.2022, e cila, mbi bazën e kërkesës së prokurorit, është shtyrë për në datën 21.12.2022. Në përfundim të gjykimit, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin 00-2022-1809 (349), datë 21.12.2022, ka vendosur mospranimin e rekurseve të paraqitura nga të gjykuarit Sajmir Brahimi dhe Q.B. Në lidhje me rekursin e kërkuesit, Kolegji Penal ka arsyetuar se ai nuk plotëson kushtet formale, pasi është nënshkruar nga mbrojtësi pa të drejtën e dhënë nga i gjykuari në kohën e paraqitjes së tij në Gjykatën e Lartë.

7. Me kërkesën e datës 30.01.2023 kërkuesi, nëpërmjet përfaqësuesit të tij sipas aktit të përfaqësimit të datës 17.01.2023, lëshuar në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimit Penal (IEVP), Fier, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me ankim kushtetues individual, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 02.03.2023.

8. Me vendimin e datës 08.05.2023 Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

9. **Kërkuesi**, ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt, në drejtim të:

9.1. *Së drejtës së aksesit*, pasi edhe pse Gjykata e Lartë ka pranuar faktin se në dosje është administruar prokura e posaçme, nuk i ka njohur të drejtën për t'u mbrojtur nëpërmjet përfaqësuesit ligjor, duke mos i dhënë mundësi që të parashtrojë shkeljet procedurale të konstatuara gjatë gjykimit në gjykatat e zakonshme, pavarësisht faktit se formalisht është dëgjuar në seancën gjyqësore të datës 21.12.2022. Gjatë gjykimit në apel ai ka autorizuar si përfaqësues ligjor avokatin S.V., sipas prokurës së posaçme të datës 03.07.2016, mbi bazën e së cilës është legjitimuar ky mbrojtës, duke iu njohur tagrat për ta mbrojtur e përfaqësuar në mungesë. Mbi bazën e kësaj prokure, të administruar në dosjen gjyqësore nga gjykata e apelit, përfaqësuesi ligjor ka ushtruar edhe të drejtën e rekursit. Qëndrimi i Gjykatës së Lartë ka cenuar edhe të drejtën e kërkuesit për të marrë pjesë në gjykim e për të zgjedhur përfaqësuesin ligjor.

9.2. *Së drejtës së mbrojtjes dhe asaj për t'u dëgjuar*, pasi gjatë gjykimit në gjykatën e apelit nuk janë respektuar dispozitat ligjore për thirrjen e të pandehurit në procesin

penal. Ankimi është paraqitur në atë gjykatë nga avokati i caktuar me prokurë nga familjarët dhe kërkuesi nuk ka pasur dijeni për procesin gjyqësor ndaj tij.

- 9.3. *Standardit të arsytimit të vendimit të Gjykatës së Lartë për shkak se, në mënyrë kontradiktore, nga njëra anë, është pranuar fakti se avokati është pajisur me prokurë të posaçme dhe, nga ana tjetër, është vendosur mospranimi i rekursit për faktin se ai nuk ka pasur tagra në kohën e paraqitjes së tij. Gjykata e Lartë e ka kaluar çështjen në seancë gjyqësore, duke pranuar se rekursi nuk paraqet të meta nga ana formale. Në raste të ngjashme të mungesës së prokurës mospranimi i rekursit është vendosur në dhomën e këshillimit dhe jo në seancë gjyqësore. Standardi i arsytimit është cenuar edhe nga gjykata e apelit, e cila e ka dënuar kërkuesin për veprën penale “Vjedhja me dhunë”, sipas neneve 139 dhe 25 të KP-së, por nuk është shprehur për veprën tjetër penale, “Plagosja e lehtë me dashje”, të parashikuar nga neni 89 i KP-së.*

10. ***Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme***, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar si vijon:

- 10.1. Në lidhje me pretendimin për *cenimin e së drejtës së aksesit*, administrata gjyqësore e Gjykatës së Lartë, megjithëse ka evidentuar të metat formale të rekursit në momentin e paraqitjes, nuk i ka dhënë mundësinë kërkuesit ta plotësonte atë, por ka vendosur *apriori* mospranimin për shkak të mungesës së tagrave të përfaqësimit. Në kuptim të aksesit real të të gjykuarit, ajo kishte detyrimin që, për sa kohë që kishte indicie për mundësinë e ekzistencës së një prokure, të bënte përpjekje të plota dhe shteruese për sqarimin e ekzistencës së saj. As nga sekretaria gjyqësore, as nga trupi gjykues nuk u bë e qartë se mbrojtësi kishte paraqitur një dokument fotokopje dhe nuk u bë thirrje për paraqitjen e dokumentit origjinal ose fotokopjes së njësuar me origjinalin. Për më tepër, Gjykata e Lartë i lejoi palët të diskutonin mbi themelin e çështjes duke e kaluar fazën e legjitimitetit të tyre dhe të rekursit. Ajo kishte detyrimin të bënte të gjitha përpjekjet për sqarimin shterues të faktit nëse mbrojtësit që kishte nënshkruar rekursin i ishin dhënë efektivisht tagra nga i gjykuari. Për rrjedhojë, është cenuar aksesit substancial, pasi Gjykata e Lartë ka interpretuar në mënyrë formale dhe në kundërshtim me orientimet e Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*) dispozitat procedurale penale për pranueshmërinë e rekursit.

10.2. Për sa kohë që shkaqet e rekursit nuk kanë marrë përgjigje dhe nuk janë shqyrtuar nga Gjykata e Lartë, ajo vendimmarrje ka cenuar edhe të drejtat e tjera të kërkuarit.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitetin e kërkuarit

11. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i” dhe pika 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

12. Në këtë këndvështrim, kërkuari, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi është palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi.

13. Në lidhje me kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, në rastin konkret Gjykata vëren se kërkuari i është drejtuar asaj me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm dhe pasi ka shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta. Kurse për pretendimet për procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë, kërkuari nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç ankimit kushtetues individual.

14. Kërkuari legjitimohet edhe *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, pasi vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, mban datën 21.12.2022, ndërsa kërkesa është paraqitur në këtë Gjykatë në datën 30.01.2023, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

15. Për sa i takon legjitimitetin *ratione materiae*, Gjykata vëren se kërkuari ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt në drejtim të së drejtës së aksesit në

Gjykatën e Lartë, për shkak të mospranimit të rekursit të paraqitur nga mbrojtësi, së drejtës së mbrojtjes dhe asaj për t'u dëgjuar për shkak se nuk është njoftuar dhe nuk ka pasur dijeni për gjykimin në gjykatën e apelit, si dhe të standardit të arsyetimit të vendimeve gjyqësore të Gjykatës së Lartë dhe asaj të apelit, pretendime këto që, për nga natyra e tyre, bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues. Megjithatë, duke pasur parasysh thelbin e këtyre pretendimeve dhe faktet kushtetuese mbi të cilat janë bazuar ato, Gjykata vlerëson që pretendimet e kërkuarit për procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë të trajtohen në vijim në këndvështrim të së drejtës së aksesit në atë gjykatë.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e së drejtës së aksesit

16. Sipas kërkuarit, në gjykatën e apelit ai ka autorizuar si përfaqësues ligjor avokatin S.V., sipas prokurës së posaçme të datës 03.07.2016, duke i njohur të gjitha tagrat për ta mbrojtur e përfaqësuar në mungesë, si dhe për të paraqitur ankim në gjykatat më të larta. Mbi bazën e kësaj prokure, ky përfaqësues ligjor ka ushtruar edhe të drejtën e rekursit. Gjykata e Lartë, edhe pse ka pranuar faktin se në dosje është administruar prokura e posaçme, nuk i ka njohur kërkuarit të drejtën për t'u mbrojtur nëpërmjet përfaqësuesit ligjor, pavarësisht faktit se formalisht avokati është dëgjuar në seancën gjyqësore të datës 21.12.2022, të zhvilluar në atë gjykatë. Gjykata e Lartë në mënyrë kontradiktore, nga njëra anë, ka pranuar faktin se avokati i kërkuarit është pajisur me prokurë të posaçme dhe, nga ana tjetër, ka vendosur mospranimin e rekursit pasi ai nuk ka pasur tagra në kohën e paraqitjes së rekursit. Ajo e ka kaluar çështjen në seancë gjyqësore, duke pranuar se rekursi nuk paraqet të meta nga ana formale, ndërkohë që në raste të ngjashme mospranimi i rekursit vendoset në dhomën e këshillimit.

17. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, ka parashtruar se ky pretendim është i bazuar, pasi administrata gjyqësore e Gjykatës së Lartë, megjithëse ka evidentuar të metat formale të rekursit në momentin e paraqitjes së tij, nuk i ka dhënë mundësinë kërkuarit ta plotësonte, por ka vendosur *apriori* mospranimin për shkak të mungesës së tagrave të përfaqësimit. Ajo gjykatë, në kuptim të aksesit real të të gjykuarit kishte detyrimin që, për sa kohë që kishte indicie për mundësinë e ekzistencës së një prokure, të bënte përpjekje të plota dhe shteruese për sqarimin e ekzistencës së saj. As nga sekretaria, as nga trupi gjyqësor nuk u bë thirrje për paraqitjen e dokumentit origjinal ose fotokopjes së njësuar me origjinalin. Gjykata e Lartë ka interpretuar në mënyrë formale dhe në kundërshtim me orientimet e Gjykatës Kushtetuese dhe GJEDNJ-së dispozitat procedurale penale për pranueshmërinë e rekursit.

18. Neni 42, pika 1, i Kushtetutës sanksionon të drejtën për proces të rregullt, ku e drejta e aksesit, që është e drejta për të vënë në lëvizje gjykatën, përbën një aspekt të saj. Aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal. Nga ana tjetër kjo e drejtë nuk ka karakter absolut dhe mund të jetë subjekt i kufizimeve, të cilat nuk duhet të kufizojnë hapësirën e aksesit të individit në një mënyrë të tillë sa të prekin thelbin e saj (*shih vendimin nr. 28, datë 16.12.2008 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka theksuar se të drejtat individuale, qoftë edhe të natyrës procedurale (këto të fundit të konceptuara në funksion edhe të garancive të të drejtave materiale), duhet të interpretohen gjithmonë në atë mënyrë që të jenë efektive (*shih vendimin nr. 5, datë 02.03.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Thelbi i së drejtës së aksesit cenohet kur rregullat procedurale pushojnë së shërbyeri qëllimeve të sigurisë juridike dhe administrimit të duhur të drejtësisë dhe formojnë një lloj pengese që pengon palën ndërgjyqëse që çështja e tij/saj të vendoset në themel nga gjykata kompetente (*shih vendimin nr. 6, datë 22.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Sipas Gjykatës, rekursi është akti procedural në të cilin parashtrohen shkaqet për të cilat kundërshtohet një vendim, sipas kërkesave të nenit 432 të KPP-së, që mundëson të drejtën e të pandehurit për të filluar gjykimin në Gjykatën e Lartë dhe, në këtë kuptim, ai është akti me të cilin garantohet e drejta për akses në atë gjykatë. Sipas nenit 435, pika 2, të KPP-së, akti i rekursit dhe memoriet duhet të nënshkruhen, me pasojë mospranimi, nga mbrojtësit, kurse sipas nenit 434/a, shkronja “d”, të KPP-së rekursi duhet të përmbajë, mes të tjerash, prokurën e avokatit në rastet kur paraqitet nga i pandehuri ose palët private. Mbrojtja me avokat e të pandehurit gjatë shqyrtimit gjyqësor në Gjykatën e Lartë është kërkesë e nevojshme në funksion të garantimit të një mbrojtjeje efektive dhe profesionale që është në interes të drejtësisë. Kërkesa për nënshkrimin e rekursit nga mbrojtësi, me pasojë mospranimin e tij, e parashikuar nga neni 435 i KPP-së, ka kuptim, para së gjithash, në funksion të aksesit që duhet të kenë të pandehurit për të ushtruar të drejtat që parashikojnë dispozitat procedurale (*shih vendimet nr. 6, datë 22.02.2022; nr. 53, datë 05.12.2012; nr. 38, datë 30.12.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Duke verifikuar respektimin e këtyre standardeve në çështjen konkrete, Gjykata, referuar akteve të dosjes gjyqësore, të administruar për qëllime të këtij gjykimi, konstaton se prokuroria e Rrethit Gjyqësor Sarandë, ka regjistruar procedimin penal nr. 346 të vitit 2014 në ngarkim të shtetasve Sajmir Brahimi dhe Q.B., për kryerjen e veprave penale “Vjedhja me armë” dhe “Plagosja e lehtë me dashje”, të kryera në bashkëpunim, të parashikuara respektivisht nga nenet 140 e 25 dhe 89 e 25 të KP-së. Me prokurën nr. 2697 rep., nr. 1221/2

kol., datë 15.12.2014, të lëshuar nga shtetasi A.B. (xhaxhai i kërkuesit) dhe prokurën nr. 71 rep., nr. 29/2 kol., datë 12.01.2015, të lëshuar nga shtetasi B.B. (babai i kërkuesit), është caktuar si përfaqësues ligjor i tij avokati Gj.I., të cilit i janë dhënë tagra përfaqësimi për të gjitha shkallët e gjykimit.

21. Gjatë procesit gjyqësor penal të zhvilluar në gjykatën e shkallës së parë, në përgjigje të urdhrorit të gjykatës së datës 20.01.2015 për njoftimin e të pandehurve nga Policia Gjyqësore, me shkresën nr. 225/1 prot., datë 28.01.2015, Komisariati i Policisë Sarandë ka informuar se njoftimi i tyre nuk është bërë i mundur pasi *“figurojnë si persona në kërkim dhe nuk ndodhen në Shqipëri”*. Në seancën gjyqësore të datës 05.02.2015, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë ka vendosur deklarinimin e mungesës së të pandehurve dhe njoftimin e tyre me shpallje, bazuar në nenin 140 të KPP-së. Procesi gjyqësor ka vijuar në mungesë të të pandehurve, të cilët janë përfaqësuar nga avokati Gj.I. dhe është po ky avokat që ka paraqitur ankim në gjykatën e apelit.

22. Gjykata e Apelit Gjirokastër ka dërguar fletëthirrje për seancën gjyqësore të datës 10.05.2015 për avokatin Gj.I. dhe dy të pandehurit. Në seancën gjyqësore të datës 10.05.2016, gjykata ka vendosur që njoftimi për të pandehurit të bëhet nëpërmjet Policisë Gjyqësore për seancën e datës 24.05.2016 dhe ka kërkuar nga Komisariati i Policisë Sarandë marrjen e masave për këtë qëllim. Në seancën gjyqësore të datës 24.05.2016 është paraqitur prokura nr. 974 rep., nr. 217/1 kol., datë 23.05.2016 me të cilën familjarët kanë emëruar si përfaqësues ligjorë avokatët Gj.I. dhe S.V., duke u dhënë të drejta dhe kompetenca që bashkërisht ose veç e veç të përfaqësojnë të pandehurit Sajmir Brahimi dhe Q.B. edhe në çdo shkallë gjykimi. Gjykata, bazuar në raportin e Policisë Gjyqësore dhe të dhënat e sistemit TIMS ka deklaruar mosgjjetjen e të pandehurve. Në seancën e datës 23.06.2016 avokati S.V. ka kërkuar shtyrjen e saj për t'u njohur me aktet e dosjes gjyqësore, si dhe për arsye se i pandehuri Q.B., i cili ishte arrestuar për qëllime ekstradimi dhe ndodhej në burgun e Janinës, kishte kërkuar të merrte pjesë në gjykim, kërkesë që është pranuar.

23. Në seancën e datës 27.07.2016 gjykata e apelit ka vendosur të ngarkojë avokatin S.V. për njoftimin e të pandehurit Q.B., kurse për të pandehurin Sajmir Brahimi (kërkuesin) ka vendosur të vijojë gjykimin në mungesë, për sa kohë që nga Policia Gjyqësore ka ardhur përgjigjja se ndodhej jashtë shtetit, duke urdhëruar njoftimin me shpallje publike në Bashkinë Konispol dhe në ambientet e saj. Në seancën gjyqësore të datës 26.10.2016, avokati S.V. është shprehur se ka dijeni se i pandehuri Sajmir Brahimi ishte ndaluar e ndodhej në burgun e Igumenicës, dhe se dëshironte të merrte pjesë në gjykim. Ai ka kërkuar shtyrjen e seancës gjyqësore për njoftimin e këtij të pandehuri dhe për të siguruar aktin e përfaqësimit (prokurën).

Gjykata, duke vlerësuar se kjo i shërbente çështjes, ka vendosur të pranojë kërkesën dhe të shtyjë seancën me qëllim marrjen e prokurës nga avokatët dhe ekstradimin e të pandehurit Sajmir Brahimi. Sipas procesverbaleve të seancave gjyqësore, seancat vijuese të datave 16.11.2016, 01.12.2016 dhe 15.12.2016 janë shtyrë për mosformim të trupit gjykues, kurse seanca e datës 20.12.2016 është shtyrë për shkak të mungesës së avokatit S.V. Në seancën e datës 10.01.2017, gjykata ka konstatuar se të pandehurit nuk janë paraqitur dhe ka vijuar gjykimin në mungesë të tyre. Në këtë seancë avokatët kanë paraqitur pretendimet përfundimtare në lidhje me çështjen dhe gjykata e apelit ka shpallur vendimin.

24. Referuar akteve të dosjes gjyqësore që i përkasin procesit në gjykatën e apelit, nuk rezulton që avokati S.V. të ketë paraqitur ose që të jetë administruar ndonjë akt përfaqësimi i nënshkruar nga kërkuesi për këtë mbrojtës. Pas shpalljes së vendimit nga gjykata e apelit avokati S.V. ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë, duke u shprehur në të se është përfaqësues i kërkuesit me prokurë të posaçme, por pa i bashkëlidhur atij kopje të aktit të përfaqësimit.

25. Gjykata konstaton, gjithashtu, se gjatë kohës që çështja ishte në shqyrtim në gjykatën e apelit kërkuesi është arrestuar në shtetin grek, konkretisht më 18.10.2016, me urdhër arresti të përkohshëm të lëshuar nga Prokurori i Apelit Korfuz dhe me shkresën e datës 31.10.2016 Prokuroria e Përgjithshme u është drejtuar autoriteteve të shtetit grek me kërkesë për ekstradimin e tij, në bazë të vendimit nr. 23-2014-2158, datë 10.12.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë për caktimin e masës së sigurimit “Arresti në burg” dhe duke qenë në pritje të gjyimit të ankimit në Gjykatën e Apelit Gjirokastër. Ekstradimi është miratuar me vendim të autoriteteve greke dhe në datën 25.10.2022 kërkuesi është marrë në dorëzim dhe është shoqëruar nga autoritetet shqiptare.

26. Për sa i përket shqyrtimit të rekursit në Gjykatën e Lartë, rezulton se me shkresën nr. 5894 prot., datë 02.11.2022 i është kërkuar avokatit S.V. që të paraqesë aktin e përfaqësimit në atë gjykatë. Sipas kësaj shkrese: *“Gjatë verifikimit të dosjes dhe kushteve formale nuk rezulton që rekursuesit Q.B. dhe S.B. t’ju kenë dhënë të drejtën për ta përfaqësuar dhe për të ushtruar të drejtën e rekursit në Gjykatën e Lartë. Referuar sa më sipër, ju lutem merrni masat për të paraqitur aktin e përfaqësimit ku rekursuesit Q.B. dhe S.B. ju kanë dhënë të drejtën për t’i përfaqësuar dhe për të ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë.”*. Me shkresën e datës 10.11.2022, avokati S.V. ka paraqitur aktin e përfaqësimit të datës 04.11.2022, të lëshuar nga kërkuesi Sajmir Brahimi në prani të autoriteteve të IEVP-së nr. 313 Tiranë, me të cilin autorizon avokatin S.V. që ta përfaqësojë në seancën gjyqësore të datës 15.11.2022, si dhe në seancat vijuese në Gjykatën e Lartë, duke u shprehur se *“të gjitha veprimet e kryera nga*

përfaqësuesi im ligjor i konsideroj të ligjshme dhe të drejta, njësoj sikur t'i kisha kryer vetë". Po ashtu, bashkëlidhur këtij akti është paraqitur edhe fotokopje e prokurës së posaçme nr. 1659 rep., nr. 634/2 kol., datë 03.07.2016.

27. Seanca e datës 15.11.2022 në Gjykatën e Lartë, e zhvilluar në dhomën e këshillimit, është shtyrë për në datën 22.11.2022 dhe në këtë të fundit Kolegji Penal, bazuar në nenin 437, pika 1, shkronja "b", të KPP-së, që parashikon shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve kur vlerësohet e nevojshme thirrja dhe dëgjimi i tyre për shkak të problematikës ose kompleksitetit të çështjes në rastet e përcaktuara në shkronjat "b" dhe "c" të pikës 1 të nenit 432 të këtij kodi, ka vendosur kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, e cila është caktuar të zhvillohet më 09.12.2022.

28. Me shkresën nr. 00500/17 prot., datë 23.11.2022, Gjykata e Lartë ka njoftuar kërkuesin dhe avokatin S.V. për datën e zhvillimit të seancës gjyqësore. Në atë seancë ka qenë i pranishëm avokati S.V., si përfaqësues i kërkuesit, por ajo është shtyrë me kërkesë të prokurorit për në datën 21.12.2022. Në seancën e radhës avokati S.V. është shprehur se ka ushtruar rekurs vetëm për të dënuarin Sajmir Brahimi **por nuk ka papajtueshmëri** për të mbrojtur edhe të dënuarin Q.B. Për rrjedhojë, ai është caktuar si mbrojtës kryesisht edhe për të pandehurin Q.B.

29. Në përfundim të gjykimit Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2022-1809 (349), datë 21.12.2022, pasi ka vlerësuar plotësimin e kriterëve formale të rekursit në kohën e paraqitjes së tij, ka vendosur mospranimin për shkak se nuk plotësoheshin kushtet formale, pasi ishte nënshkruar nga mbrojtësi pa të drejtën e dhënë nga i gjykuari. Pasi ka analizuar procedurën e ndjekur gjatë gjykimit të çështjes në gjykatat e faktit, si dhe aktet e përfaqësimit të lëshuara për përfaqësuesit ligjorë të të gjykuarve, Kolegji Penal ka konstatuar se pas njoftimit nga sekretaria e Gjykatës së Lartë për plotësimin e kushteve formale të rekursit në lidhje me të drejtën e dhënë nga i pandehuri për të paraqitur rekurs, mbrojtësi ka paraqitur një fotokopje të panoterizuar të prokurës nr. 1659 rep., nr. 634/2 kol., datë 03.07.2016, e cila nuk plotëson kushtet e një akti përfaqësimi. Ndërkohë që marrja e autorizimit në datën 04.11.2022 nuk e shëron të metën formale, pasi rekursi është paraqitur më 07.02.2017, pa pasur avokati tagra nga i pandehuri. Rekursuesi është gjykuar në mungesë në gjykatën e shkallës së parë dhe në apel, duke u përfaqësuar nga avokatë të caktuar nga familja, në kundërshtim me ligjin procedural dhe praktikën unifikuese të Gjykatës së Lartë. Mbrojtësit e caktuar nga familjarët nuk kishin tagra për të ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë dhe për rihapjen e procesit gjyqësor në mungesë duhen ushtruar mjete të tjera procedurale të parashikuara nga ligji

procedural (*shih paragrafin 23 të vendimit të Kolegjit Penal*). Ata duhet të prisnin momentin e vënies në dijeni të vendimit nga ana e të gjykuarit për të rivendosur në afat të drejtën e ankimit ose për të kërkuar rishikimin e vendimit (*shih paragrafët 29 dhe 31 të vendimit të Kolegjit Penal*). Në interpretim dhe zbatim të dispozitave të KPP-së dhe vendimeve unifikuese të asaj gjykate, si dhe vendimeve të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me të drejtën e mbrojtjes së të gjykuarit në mungesë, Kolegji Penal ka arritur në përfundimin se nga ana e mbrojtësve (pa tagra) është zgjedhur në mënyrë të gabuar mjeti procedural i rekursit dhe se të dënuarit duhet të kërkojnë rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit për vendimin e gjykatës së apelit ose rishikimin e vendimit nëse janë gjykuar në mungesë dhe nuk kanë pasur dijeni për gjykimin (*shih paragrafët 46 dhe 55 të vendimit të Kolegjit Penal*).

30. Gjykata, në këndvështrim të së drejtës së aksesit, ka theksuar se trajtimi i mjetit procedural në mënyrë josubstanciale cenon të drejtën e mbrojtjes të të gjykuarit dhe njëkohësisht aksesin e tij në Gjykatën e Lartë (*shih vendimet nr. 53, datë 05.02.2012; nr. 29, datë 15.05.2012 të Gjykatës Kushtetuese*). Po kështu, dispozitat e KPP-së nuk mund të interpretohen nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në një mënyrë të tillë të ngushtë që cenon thelbin e së drejtës së një individi për t'iu drejtuar asaj gjykate (*shih vendimet nr. 6, datë 22.02.2022; nr. 53, datë 05.12.2012; nr. 38, datë 30.12.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

31. Gjykata konstaton se në dosjen gjyqësore të Gjykatës së Lartë gjendet e administruar një fotokopje e prokurës nr. 1659 rep., nr. 634/2 kol., datë 03.07.2016, e hartuar në Filat të Greqisë, në gjuhën shqipe, nga noteri i Dhomës së Noterisë Gjirokastër, e cila është konsideruar nga ajo gjykatë se nuk plotëson kushtet e një akti përfaqësimi. Gjykata konstaton, gjithashtu, se bashkëlidhur ankimit kushtetues individual përfaqësuesi i kërkuesit ka paraqitur prokurën nr. 1659 rep., nr. 634/2 kol., datë 03.07.2016, kopje origjinale të saj, me të cilën kërkuesi u ka dhënë tagra avokatëve Gj.I. dhe S.V., për ta përfaqësuar para Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Sarandë, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, Gjykatës së Apelit Gjirokastër, si dhe para gjykatave të tjera të çdo shkalle gjykimi, për çështjet penale për të cilat akuzohet, gjatë hetimeve paraprake dhe gjatë gjyimit të kësaj çështjeje, duke pasur ata të drejtën që, mes të tjerash, të bëjnë ankim dhe rekurs ndaj vendimeve të gjykatave dhe atyre të prokurorisë.

32. Për sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se kërkuesi e ka shprehur në mënyrë të qartë vullnetin për zgjedhjen e avokatit S.V. dhe tagrat e dhëna këtij të fundit në procesin gjyqësor që po zhvillohej ndaj tij. Megjithatë, edhe pse prokura rezulton që të jetë lëshuar gjatë kohës që çështja ishte në shqyrtim në gjykatën e apelit, ajo jo vetëm që nuk rezulton e

administruar në dosjen gjyqësore, por, edhe pse ajo gjykatë ka shtyrë gjykimin për këtë shkak, pasi është vënë në dijeni nga mbrojtësi i zgjedhur nga familjarët e kërkuarit, nuk është shprehur as në procesverbalet e seancave gjyqësore dhe as në vendim në lidhje me këtë fakt, ndërkohë që ka lejuar mbrojtjen e kërkuarit edhe nga ky avokat në cilësinë e avokatit me prokurë, por pa treguar specifikimet e saj.

33. Nga ana tjetër, Gjykata e Lartë, pasi ka verifikuar kërkesat formale të paraqitjes së rekursit i ka kërkuar përfaqësuesit të kërkuarit të paraqesë aktin e përfaqësimit në atë gjykatë. Pas paraqitjes së akteve nga mbrojtësi, Gjykata e Lartë ka vendosur ta kalojë çështjen për shqyrtim në seancë gjyqësore, ku ka vendosur mospranimin e rekursit me arsyetimin se ai nuk plotësonte kushtet formale. Në seancën gjyqësore të zhvilluar në atë gjykatë me praninë e palëve, ku kërkuari është përfaqësuar nga avokati S.V., Gjykata e Lartë nuk ka bërë asnjë përpjekje që ajo vetë, tashmë, të sqaronte pozitën procedurale të këtij mbrojtësi, referuar aktit të përfaqësimit (prokurë) që rezulton, edhe sipas kopjes së paraqitur në atë gjykatë, se është lëshuar gjatë kohës që çështja ndodhej në gjykatën e apelit, pra para paraqitjes së rekursit, duke ia nënshtruar këtë çështje debatit gjyqësor dhe duke vendosur, nëse ishte e nevojshme, edhe shtyrjen e seancës për këtë shkak. Edhe në vendimin e asaj gjykate është konstatuar fakti se në seancën gjyqësore të datës 23.10.2016, avokati S.V. i ka bërë me dije gjykatës së apelit se i pandehuri Sajmir Brahimi ishte ndaluar në Igumenicë për efekt ekstradimi dhe se dëshironte të merrte pjesë në gjykim e për këtë shkak është kërkuar shtyrja e seancës (*shih paragrafin 28 të vendimit të Kolegjit Penal*), por më tej nuk është analizuar në lidhje me këtë fakt. Nga ana tjetër, Gjykata e Lartë ka mbajtur qasjen se marrja e autorizimit të datës 04.11.2022 nuk e shëron këtë të metë formale të së drejtës për të paraqitur rekurs, ndërkohë që përmes këtij autorizimi, në fakt, kërkuari ka konfirmuar tagrat e përfaqësimit të dhëna tashmë këtij mbrojtësi.

34. Gjykata e Lartë ka vlerësuar, gjithashtu, se kërkuari ka përdorur mjetin e gabuar juridik, pasi duhej të kërkonte rivendosjen në afat të ankimit për vendimin e gjykatës së apelit për shkak të pamundësisë së ushtrimit të tij ose rishikimin në rast të gjykimin në mungesë, nëse nuk ka pasur dijeni, afat që fillon nga dita e marrjes dijeni të këtij vendimi (*shih paragrafët 46 dhe 55 të vendimit të Kolegjit Penal*). Pavarësisht se ajo gjykatë i ka njohur kërkuarit të drejtën për t'iu drejtuar gjykatave të zakonshme për të pasur një rishqyrtim të çështjes së tij, duke e orientuar drejt mjeteve të tjera ligjore që parashikojnë dispozitat procedurale për rihapjen e procesit gjyqësor, Gjykata nuk vlerëson të vërë në diskutim mundësitë e suksesit të këtyre mjeteve për sa i përket çështjes penale të kërkuarit, për sa kohë

që në rastin konkret, pavarësisht se ai ka qenë në pritje të procedurave të ekstradimit, ka zgjedhur të mbrohet përmes mjeteve të zakonshme të ankimit dhe pas marrjes dijeni për procesin, i ka dhënë tagra përfaqësuesit ligjor për të vijuar gjykimin në të gjitha shkallët e gjyimit edhe në mungesë të tij. Ndërkohë, interpretimi që Gjykata e Lartë i ka bërë mjetit të zgjedhur nga vetë kërkuesi, përbën një pengesë joproporcionale për ushtrimin efektiv të së drejtës së aksesit në atë gjykatë.

35. Gjykata ka vlerësuar në raste të ngjashme shkaqet që kanë çuar në vendimin e mospranimit të rekursit, përfshirë veprimet dhe mosveprimet e organeve shtetërore, nëse ato kanë hetuar dhe verifikuar në mënyrën e duhur përfaqësimin dhe tagrat e mbrojtësit, ashtu edhe sjelljen e vetë kërkuesit ose të mbrojtësit të tij, për të arritur në përfundimin nëse kanë qenë në nivelin e duhur gjatë procesit gjyqësor (*shih vendimet nr. 12, datë 24.05.2022; nr. 6, datë 22.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë drejtim Gjykata, vlerëson të theksojë se sjellja dhe përpjekjet e avokatit nuk kanë qenë në nivelin e duhur dhe se pavarësisht se ka qenë në dijeni të prokurës së posaçme, mbi të cilën ka paraqitur rekursin në Gjykatën e Lartë, nuk e ka paraqitur këtë akt në formën e kërkuar nga ligji, as pasi i është kërkuar nga administrata e asaj gjykate dhe as në seancë gjyqësore. Në ndryshim nga sa më sipër, bashkëlidhur ankimit kushtetues individual ky avokat ka paraqitur edhe kopje origjinale të aktit të përfaqësimit (prokurës).

36. Për sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se qëndrimi i Gjykatës së Lartë, duke mos pranuar rekursin me arsyetimin se është paraqitur nga një mbrojtës pa tagra, ndërkohë që përfaqësimi dhe ushtrimi i të drejtave në funksion të mbrojtjes janë realizuar në bazë të prokurës së posaçme të nënshkruar nga kërkuesi, e cila, sikurse u përmend më lart, i është bashkëlidhur ankimit kushtetues individual, ka cenuar të drejtën e aksesit në atë gjykatë, duke e bërë procesin të cenueshëm nga pikëpamja kushtetuese. Qëndrimi i asaj gjykate, duke mos hetuar në lidhje me këtë fakt të pretenduar si në komunikimin shkresor me atë gjykatë, ashtu edhe në seancë gjyqësore nga ana e mbrojtësit, ka sjellë mohimin absolut të së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë përgjigje përfundimtare për pretendimet e ngritura. Gjykata e Lartë, në kuptim të rrethanave të faktit të evidentuara më sipër, kishte të gjitha hapësirat që kërkesat ligjore për elementet formale që duhet të plotësojë rekursi, në përputhje me funksionin e saj të interpretimit të normës dhe në kuptim të parimit të subsidiaritetit e pozicionit të saj në piramidën gjyqësore, t'i interpretonte me qëllim garantimin e të drejtave themelore të individit, konkretisht të së drejtës së aksesit substancial.

37. Në lidhje me pretendimet e tjera të kërkuessit, që kanë të bëjnë me të drejtën e mbrojtjes në gjykimin në apel dhe standardin e arsytimit të vendimit të gjykatës së apelit për shkak se ajo gjykatë nuk është shprehur për veprën penale të parashikuar nga neni 89 i KP-së, Gjykata, duke mbajtur në konsideratë se në zbatim të parimit të *subsidiaritetit* kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese është funksion edhe i Gjykatës së Lartë, çmon të mos ndalet në analizimin e tyre, për sa kohë që çështja do të merret sërish në shqyrtim nga ajo gjykatë, e cila duhet t’u japë atyre përgjigje të arsyetuar.

38. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuessit për cenimin e së drejtës së aksesit në Gjykatën e Lartë, për shkak të mospranimit të rekursit të paraqitur nga mbrojtësi i pajisur me tagra përfaqësimi, është i bazuar, sipas arsytimit të mësipërm të këtij vendimi, ndaj kërkesa pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

V E N D O S I:

1. Pranimin pjesërisht të kërkesës.

2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2022-1809 (349), datë 21.12.2022 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, vetëm për kërkuessin Sajmir Brahimi.

3. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 09.11.2023

Shpallur më 12.12.2023